



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 305/4 Prot

Tiranë, më 27.05.2020

V E N D I M

Nr.34, datë 27.05.2020

Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të informacionit të përcjellë me shkresën nr. 305 prot., datë 04.05.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me procedurën e konkurrimit zhvilluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, për trajtimin e informacionit të përcjellë prej Presidentit të Republikës, në lidhje me pretendimet për paligjshmëri të konkurrentes
*****,

VËREJ SE:

Nëpërmjet kërkesës nr. 305 prot., datë 04.05.2020, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me ankesën e paraqitur nga konkurrentja ***** , e cila ka ngritur pretendimin për shkelje të rregullave procedurale dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në zhvillimin e procedurës së konkurrimit, nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik”, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka publikuar shpalljen për zhvillimin e procedurës së konkurrimit, nëpërmjet lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, për pozicionin e

nivelit të ulët drejtues “Përgjegjës i Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë” – kategoria e pagës III-a.

Në kuptim të nenit 24, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, fillimisht për pozicionin e mësipërm është zhvilluar procedura e lëvizjes paralele. Në përfundim të procesit të verifikimit paraprak të kandidatëve, në lidhje me përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, rezulton se, ankuesja ***** është një nga kandidatet e kualifikuara për të vijuar më tej në fazën e dytë të konkurrimit për lëvizjen paralele, fakt i cili materializohet në aktin e publikuar në portalin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rubrikën: “Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak”. Më tej, rezulton se intervista e strukturuar me gojë, me pjesëmarrësit e kualifikuar, është zhvilluar në datën 05.03.2020.

Pas zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë, rezulton se, Komiteti i Pranimit ka kryer vlerësimin në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar prej saj (si përvoja, trajnimet dhe vlerësimet e rezultateve individuale në punë), si dhe për intervistën me gojë. Në përfundim të këtij procesi konstatohet se, Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele ka vlerësuar kandidaten në fjalë me 59 pikë në total, fakt i cili gjen pasqyrim në raportin e datës 05.03.2020, “Mbi zhvillimin e konkurrimit sipas procedurës së lëvizjes paralele, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Në zbatim të pikës 26, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse ka njoftuar kandidaten individualisht për rezultatin, e për rrjedhojë skualifikimin e saj, nëpërmjet e-mailit të datës 06.03.2020.

Nga verifikimi i faqes zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rezulton se, njësia përgjegjëse në këtë institucion ka publikuar aktet administrative për përfundimin e kësaj procedure pa kandidatë fitues dhe vijimin e konkurrimit nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, duke lejuar pjesëmarrjen edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Rezulton se, konkurrentja ***** nuk ka qenë dakord me rezultatin e vlerësimit dhe për këtë arsye, i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 135/1 prot., datë 09.03.2020, nëpërmjet të cilës ka pretenduar për paligjshmëri dhe për shkelje të rregullave procedurale në zhvillimin e procedurës së konkurrimit nga Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele.

Në rastin konkret, ankuesja ka ngritur pretendimin se procedura e konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele është kryer në kundërshtim të hapur me dispozitat e ligjit për nëpunësin civil, duke parashtruar se, **a)** përbërja e Komitetit të Pranimit nuk ka qenë në përputhje me

përcaktimet e aktit nënligjor; **b)** intervista e strukturuar me gojë nuk është regjistruar, për shkak se nga ana e institucionit nuk janë siguruar mjetet e përshtatshme për të kryer këtë veprim; **c)** lista e pyetjeve e hartuar nga Komiteti i Pranimit nuk ka qenë e pikëzuar dhe e nënshkruar nga anëtarët e këtij komiteti dhe se **d)** nuk është njoftuar në mënyrë të detajuar në lidhje me vlerësimin e pikëzuar të intervistës së strukturuar me gojë.

Për më tepër, kandidatja *****, pretendon se njësia përgjegjëse ka publikuar njoftimin për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele pa kandidatë fitues dhe vijimin e konkurrimit, në të njëjtën ditë kur ankuesja ka marrë dijeni në lidhje me vlerësimin përfundimtar, duke mos i garantuar në këtë mënyrë ushtrimin e të drejtës së ankimit, të përcaktuar në pikën 27, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim çështjen dhe me shkresën nr. 135/2 prot., datë 24.03.2020, i ka kthyer përgjigje kandidates *****, duke sqaruar se pretendimet e saj janë të pabazuara pasi, si nga Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele edhe nga njësia përgjegjëse janë respektuar të gjitha kërkesat ligjore në kuadër të zhvillimit të një konkurrimi të drejtë dhe transparent.

Duke analizuar gjithë sa u parashtrua më sipër, ku përfshihen pretendimet e ankueses, dokumentacioni i dërguar nga institucioni, si dhe aktet e tjera të administruara gjatë verifikimit të rastit, arrihet në përfundimin se, procedura e konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë*”, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, për arsyet që do të parashtrohen në vijim.

Në Kreun II, pika 16, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, përcaktohet se, me qëllim vlerësimin e kandidatëve të kualifikuar për fazën e dytë të konkurrimit, në procedurën e lëvizjes paralele, urdhërohet ngritja e Komitetit të Pranimit për Lëvizjen Paralele, i cili në përbërje të tij ka 3 anëtarë.

Në rastin konkret, rezulton se, me urdhrin nr. 10, datë 04.03.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është ngritur Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele, me përbërje si më poshtë:

- Ndhmës Magjistrate, *****
- Drejtor Departamenti, *****
- Drejtor Drejtorie, *****

Nisur nga sa më sipër, vlerësohet se, Komiteti i Pranimit për procedurën e konkurrimit për pozicionin *”Përgjegjës i Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë”* është ngritur në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, duke mos përlligjur në këtë mënyrë pretendimet e kandidatës *****, për përbërje të gabuar të këtij organi administrativ (*me 2 anëtarë*). Për më tepër, vërehet se të gjitha aktet administrative të përpiluara, me qëllim për të dokumentuar intervistën e strukturuar me gojë, janë nënshkruar nga të tre anëtarët e këtij komiteti.

Njëkohësisht, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson si të pabazuar edhe pretendimin tjetër të ankueses ***** se, prej saj është kërkuar regjistrimi i intervistës së strukturuar me gojë, por ky veprim nuk është kryer për shkak se nga ana e institucionit nuk disponohej pajisja përkatëse e regjistrimit. Nga shqyrtimi i dosjes që materializon procedurën e konkurrimit rezulton se pjesë e saj është edhe akti *“Formular deklarimi”*. Nga përmbajtja e këtij dokumenti konstatohet se, kandidatja ka pranuar me vullnet të lirë dhe të plotë se, nuk dëshiron regjistrimin e kësaj interviste dhe për më tepër, nuk konstatohet të jenë parashtruar argumente të tjera në lidhje me këtë fakt.

Në vijim të analizës së vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve të ngritura nga kërkuesja *****, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni i mbikëqyrur, vlerësohet si i pabazuar në ligj edhe pretendimi se lista e pyetjeve të përgatitura për intervistën e strukturuar me gojë, nuk ka qenë e pikëzuar dhe e nënshkruar nga anëtarët e komitetit.

Në rastin konkret, rezulton se, prej Komitetit të Pranimit janë përgatitur **5** pyetje, nga të cilat për **4** pyetje është parashikuar vlerësimi maksimal me 10 pikë dhe për pyetjen e pestë vlerësimi maksimal me 20 pikë. Për më tepër, ky akt rezulton të jetë nënshkruar nga anëtarët e komitetit, si dhe të përmbajë vulën e insitucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Nga sa më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin dhe vlerëson se Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele ka vepruar në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj, të cilat përbëjnë garanci për respektimin dhe zbatimin e parimit të shanseve të barabarta, të mosdiskriminimit dhe transparencës në zhvillimin e procedurave të konkurrimit.

Nga verifikimi i akteve të administruara në kuadër të hetimit administrativ, rezulton se, në zbatim të të Kreut II, pika 25, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, Komiteti i Pranimit, nëpërmjet raportit të datës 05.03.2020, *“Mbi zhvillimin e konkurrimit sipas procedurës së levizjes paralele, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik (III-a), në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ka komunikuar njësisë

përgjegjëse të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezultatin e vlerësimit për kandidatet e intervistës së strukturuar me gojë.

Më tej, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka njoftuar individualisht kandidaten për pikët e fituara dhe për skualifikimin e saj nga kjo procedurë konkurrimi. Pretendimi i kandidates *****, se njësia përgjegjëse nuk i ka vënë në dispozicion vlerësimin e detajuar mbi rubrikat përkatëse të procedurës së konkurrimit, nuk qëndron, pasi në dispozitat e aktit nënligjor të sipërcituar nuk përcaktohet shprehimisht një detyrim i tillë ligjor.

Nga ana tjetër, në vlerësim të dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson të padrejtë edhe pretendimin e kandidates se i është mohuar e drejta e ankimit, me argumentin se, njësia përgjegjëse e institucionit, pas njoftimit të rezultatit, ka publikuar menjëherë njoftimin për vazhdimin e procedurës së konkurrimit, nëpërmjet ngritjes në detyrë, duke mos respektuar në këtë mënyrë afatin për procedurat e ankimit.

Kjo për faktin se, në Kreun II, pika 27, të të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, përcaktohet se:

“Kandidati, pavarësisht nga e drejta për t’u ankuar në gjykatën administrative, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në Komitetin e Pranimi për Lëvizjen Paralele, për rezultatin e pikëve, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit”.

Në referencë të dokumentacionit që materializon procedurën e konkurrimit, konstatohet se kandidata në fjalë nuk ka ushtruar ankim pranë këtij komiteti. Shkresa nr. 135/1 prot., datë 09.03.2020, drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk përligj pretendimet e kësaj konkurrenteje, pasi për sa është argumentuar më sipër, organi kompetent për shqyrtimin e ankesave ndaj rezultateve të vlerësimit është vetëm Komiteti i Pranimi për Lëvizjen Paralele.

Nga ana tjetër, krahas arsyetimit të mësipërm, Komisioneri vëren se, në portalin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pas njoftimit individual të kandidates në lidhje me vlerësimin, njësia përgjegjëse ka publikuar dy akte të njëpasnjëshme, konkretisht:

1. Njoftim paraprak mbi shpalljen e fituesit për procedurën e lëvizjes paralele;
2. Njoftim mbi shpalljen e fituesit për procedurën e lëvizjes paralele.

Ekzistenca e akteve të mësipërme vërteton se, njësia përgjegjëse ka respektuar dispozitat ligjore në lidhje me afatin për ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe më pas, ka vijuar me procedurën e konkurrimit, nëpërmjet ngritjes në detyrë.

Nga sa është parashtruar më sipër, në analizë të dokumentacionit të administruar dhe fakteve të çështjes konkrete, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në përfundimin se pretendimi i ankueses *****, për paligjshmëri në zhvillimin e procedurës së konkurrimit për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë”*, është i padrejtë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe në nenin 34, pika 1, të të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 302 prot., datë 04.05.2020, dërguar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pretendimet e konkurrentes ***** për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit Juridik, në Drejtorinë Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë”*, në Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.
2. Të njoftohet për këtë vendim Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe nëpunëses *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha